



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 12.09.2020
Dokument parlamentar

RAPORT
MBI SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
NR.11591, DATË 10.08.2020, “PËR KTHIMIN NË KUVEND TË
LIGJIT NR.113/2020, “PËR SHTETËSINË”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 09.09.2020, Dekretin e Presidentit të Republikës nr.11591, datë 10.08.2020, “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.113/2020, “Për shtetësinë”.

Për shqyrtimin i pretendimeve të ngritura në Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit për rishqyrtim, i pranishëm në komision ishte z.Julian Hodaj, Zëvendësministër i Brendshëm.

Gjithashtu për të mbrojtur argumentat e kthimit të ligjit për rishqyrtim, morën pjesë edhe përfaqësues të Presidentit të Republikës.

- ***Baza ligjore e shqyrtimit të Dekretit***

Baza Ligjore mbi të cilën Komisioni për Sigurinë Kombëtare, shqyrton Dekretin e Presidentit është:

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 85 të saj përcakton se:***

Neni 85

1. *Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
2. *Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

- ***Rregullorja e Kuvendit, e cila në nenin 86 të saj përcakton se:***

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.

2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

- **Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr.113/2020, “Për shtetësinë”**

Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. nr.113/2020, “Për shtetësinë”, duke argumentuar si më poshtë:

1. Neni 8 i ligjit nr. 113/2020, përcakton dispozitën e fitimit të shtetësisë me natyralizim dhe rendit kushtet ligjore kumulative që duhen përmbushur. Kriteret e përcaktuara në këtë dispozitë kufizojnë të drejtat e subjekteve për të aplikuar/marrë shtetësinë shqiptare në mënyrë jo proporcionale, ndërsa terminologjia e përdorur në këtë dispozitë është në kundërshtim me nenet 19 dhe 92 të Kushtetutës.

1.1 Vetë terminologjia e përdorur në nenin 8, dhe në tërësi në tekstin e këtij ligji, sa i takon konceptit të shtetësisë si e drejtë që “fitohet”, kur bëhet fjalë për shtetësi me natyralizim, është terminologji e gabuar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 19, pika 1, përcakton se:

“Kushdo që lind, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera, të parashikuara me ligj.”

Pra, “fitimi” i shtetësisë shqiptare lidhet me lindjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose me origjinën shqiptare. Në rastin e lindjes, për ilustrim, vetë konstatimi i faktit të lindjes në territorin e Republikës së Shqipërisë bën që të regjistrohet shtetësia shqiptare, si një e drejtë e fituar me konstatimin e faktit.

Ndërsa neni 92 i Kushtetutës, kur referon në kompetencën e Presidentit për dhënien e shtetësisë shqiptare, përdor pikërisht emërtimin “jep” shtetësinë shqiptare.

Ndaj dhe neni 8 i ligjit dhe çdo dispozitë që lidhet me marrjen e shtetësisë shqiptare jo për shkak të lindjes apo origjinës, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës,

duke përdorur emërtimin “dhënie” dhe “marrje” e shtetësisë shqiptare, dhe jo me emërtimin “fitim”.

Përdorimi i emërtimit “rifitim” i shtetësisë shqiptare, nuk njihet nga Kushtetuta. Në këtë rast, ligji duhet të përcaktojë procedurat për “fitimin” apo përkatësisht “marrjen” e shtetësisë shqiptare.

1.2 Në nenin 8, shkronja “c)” parashikohet si kusht për aplikimin për marrje të shtetësisë shqiptare me natyralizim, fakti që shtetasi i huaj: *“Të qëndrojë në mënyrë të ligjshme dhe të banojë për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vite në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka përfituar leje të përhershme qëndrimi, të vlefshme në momentin e paraqitjes së kërkesës, sipas ligjit për të huajt.”*

Nëse ligjvënësi ka vlerësuar se nëpërmjet këtij ligji do të kufizojë mundësitë dhe forcojë kriteret që parashikohen në legjislacionin ekzistues për marrjen e shtetësisë shqiptare, kjo kërkon një diskutim më të gjerë me të gjithë aktorët, për sa kohë që lidhet direkt edhe me politikën që ndikon në popullsinë e Republikës së Shqipërisë.

Ndaj, mes Kuvendit dhe Presidentit të Republikës duhet të kishte pasur paraprakisht një diskutim me fokus trajtimin e thelluar të çështjeve rreth kësaj politike.

Kjo çështje me kaq ndjeshmëri nuk mund të lihet, sipas pikës 7 të këtij neni, për t’u detajuar në një udhëzim të një ministri.

1.3 Neni 8, shkronja “ç”, rendit si kusht për marrjen e shtetësisë me natyralizim, kërkesën që i huaji të ketë banesë. Konkretisht, citojmë këtë parashikim: *“Ka banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në Republikën e Shqipërisë.”*

Ky lloj formulimi nënkupton që shtetasi i huaj duhet të ketë në pronësi të tij një banesë, duke krijuar kështu një barrë jo proporcionale për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kriter i mjaftueshëm për marrjen e shtetësisë, është dhe vetëm fakti i zotërimit të një banesë sipas standardeve të banimit.

1.4 Përfshirja e kushtit të zotërimit të njohurive të gjuhës shqipe, të folur e të shkruar, si dhe të njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë është shumë i mirëpritur, për sa kohë shtetasit e huaj, të cilëve u jepet shtetësia shqiptare, duhet të dëshmojnë njohje dhe lidhje me vendin tonë. Por formulimi i shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 8, është tërësisht evaziv sa i përket mënyrës së përcaktimit të nivelit të njohurive dhe institucioneve që do të vërtetojnë zotërimitin e këtyre njohurive si të gjuhës shqipe, ashtu edhe të historisë së Republikës së Shqipërisë.

Për të shmangur konfuzionin si dhe për të garantuar trajtim të barabartë, ligji duhet të përcaktojë, ose të orientojë në përcaktimin e qartë të këtyre dy elementeve

1.5 Pika 2, e nenit 8, parashikon se:

“2. Në rast se personi është pa shtetësi, ai mund ta fitojë shtetësinë shqiptare nëse plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “c”, “dh” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni.”

Ndërkohë që, shkronja “c” e pikës 1, përcakton si kusht për dhënien e shtetësisë me natyralizim që shtetasi i huaj:

“c” Qëndron në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vite në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka përfituar leje të përhershme qëndrimi, të vlefshme në momentin e paraqitjes së kërkesës, sipas ligjit për të huajt;”.

Parimi i këtij ligji është ai i shmangies së gjendjes pa shtetësi, sanksionuar në nenin 3, shkronja “b”, si dhe garantuar nga Konventa për Statusin e Personave pa Shtetësi, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar që në vitin 2003, me ligjin nr. 9057, datë 24.4.2003.

Ndaj, ose referenca e pikës 2 të këtij neni në shkronjën “c” të pikës 1 është një lapsus i ligjvënësit apo gabim në zbardhjen e aktit, ose ndryshe është e pakuptueshme, se si për personat pa shtetësi, kërkohet si kusht që të kenë banuar për një periudhë prej jo më pak se 7 vite në Shqipëri si dhe të kenë përfituar edhe leje të përhershme qëndrimi.

Ky parashikim, që as nuk specifikon qartë se cilës kategori të personave iu referohet (shtetas shqiptarë që kanë hequr dorë nga shtetësia, apo dhe shtetas që nuk kanë pasur kurrë shtetësinë shqiptare dhe janë pa shtetësi), bie në kundërshtim me parimin e shmangies së pashtetësisë dhe të drejtën e çdo personi për të gëzuar të paktën një shtetësi, kur si kriter kërkohet qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë relativisht të gjatë prej 7 vitesh.

1.6 Në nenin 8, pikat 4, 5 dhe 6, duhet të saktësohet procedura e paraqitjes së kërkesës për marrjen e shtetësisë shqiptare me natyralizim për fëmijët nën moshën 18 vjeç. Nga mënyra e formulimit të këtyre dispozitave, kuptohet sikur aplikimi për këto raste bëhet direkt përpara zyrës së gjendjes civile. Ndërkohë që edhe në këto raste, duhet të ndiqet procedura e njëjtë me paraqitjen e kërkesës, shqyrtimit të dokumentacionit dhe përcjelles së propozimit pranë Presidentit të Republikës për vlerësim, deri në shprehjen e tij.

Po kështu, edhe në nenin 10, të ligjit, duhet të saktësohet procedura për marrjen e shtetësisë shqiptare me birësim.

2 Neni 9, i ligjit, që trajton dispozitën e rasteve të veçanta të fitimit të shtetësisë shqiptare, shkel nenin 19 dhe 92 të Kushtetutës, si dhe mbivendos organet shtetërore duke dubluar kompetencat dhe fryrë administratën, në shkelje të efijencës dhe duke shkaktuar kosto direkte në buxhetin e shtetit.

Neni 9, pika 1, përcakton se:

“Shtetësia shqiptare mund të fitohet nga shtetasi i huaj që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, kur nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, edhe në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit.”

Sipas pikës 4, të këtij neni, në këtë rast, nuk zbatohet procedura e zakonshme për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës, sipas përcaktimeve të neneve 17 dhe 18 të Ligjit. Pikërisht këto janë rastet kur Presidenti i Republikës mund të ushtrojë kompetencën direkte për dhënien e shtetësisë shqiptare, për shtetas, të cilët nuk përbëjnë kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare dhe që kanë një kontribut specifik në një fushë të caktuar.

Por pikat 2 dhe 3 të këtij nen përmbajnë një rregullim tërësisht të paqartë. Konkretisht, këto dy pika parashikojnë se:

“2. Për hartimin e programeve të veçanta, përcaktimin e rregullave specifike të kontrollit të veçantë të sigurisë dhe pastërtisë së figurës në standardet më të larta dhe monitorimin e zbatimit të tyre, krijohet një agjenci shtetërore e posaçme në varësi të ministrit. Organizimi dhe funksionimi i agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kriteret për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, procedurat e aplikimit, rregullat e kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit dhe ministrave përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.”

Nga ky formulim lindin këto paqartësi:

21 Cilave “***programe të veçanta***” iu referohen pikat 2 dhe 3 të nenit 9, kur as pika 1, as ndonjë dispozitë tjetër e këtij ligji, nuk referon apo as nuk rregullon “programet”? Vetë pika 3, iu referohet gabim: “*Programeve të veçanta të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*”, por pika 1 nuk ka një përcaktim të tillë.

22 Për cilët subjektet do të aplikohen: “*Rregullat specifike të kontrollit të veçantë të sigurisë dhe pastërtisë së figurës*”? Për rastet e veçanta të dhënies së shtetësisë shqiptare, apo për çdo rast? Dispozita nuk e qartëson këtë fakt.

23 Cilat janë “*Standardet më të larta të pastërtisë së figurës dhe sigurisë*”? Kush i përcakton ato dhe ku mbështeten?

24 Në këtë rast, cili institucion do të përcjellë propozimin për pranimin, ose refuzimin

e dhënies së shtetësisë pranë Presidentit të Republikës, që ka tagrin kushtetues për të dhënë shtetësinë?

25 Pse për rastin e dhënies së veçantë të shtetësisë, synohet të përdoret standard i ndryshëm nga fitimi i shtetësisë me natyralizim apo për shkak të origjinës, duke shkaktuar pabarazi në trajtimin e kërkesave? Veçanërisht, kur kjo pabarazi vjen në verifikimin e sigurisë dhe pastërtisë së figurës, kur si fitimi, ashtu edhe dhënia e shtetësisë shqiptare, duhet të garantojnë të njëjtin standard verifikimi dhe kontrolli, kur bëhet fjalë për sigurinë kombëtare.

26 Cili do jetë roli dhe funksioni i “agjencisë shtetërore të posaçme”, që për sa kohë krijohet nga ky ligj, duhet të kishte të përcaktuar jo vetëm emërtimin, por edhe rolin dhe funksionin e saj?

Lidhur me këtë agjenci të re që parashikohet të krijohet, sjellim në vëmendjen tuaj se ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” ka përcaktuar në nenin 4, pika 2, se:

“Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

- a) Kryeministria; b) ministritë; c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave; ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve; d) agjencitë autonome; dh) administrata e prefektit.”*

Nëse në rastin konkret, synimi i ligjvënësit ka qenë krijimi i një “agjencie” sipas kuptimit të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 4, të sipërcituar, sjellim në vëmendjen tuaj se, sipas nenit 10 të ligjit nr. 90/2012, agjencitë autonome krijohen dhe mbyllen me ligj!

Nëse synimi ka qenë krijimi i një “institucioni në varësi të ministrit”, neni 6, i ligjit nr. 90/2012, sërish disiplinon krijimin e tyre duke përcaktuar se:

“1. Institucionet e varësisë mund krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim, dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën apo shërbimeve të brendshme për administratën shtetërore, ose mbështetje e këshillim për ministrinë.

2.Përveçse kur parashikohen drejtpërdrejt nga ligji, institucionet e varësisë krijohen dhe mbyllen nga këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës apo përkatësisht kryeministrit, si dhe kanë personalitet juridik publik.

3.Në vendimin e këshillit të Ministrave për krijimin e një institucioni të varësisë përcaktohen, të paktën: a) emri dhe selia; b) misioni; c) funksionet administrative që i delegohen; ç) ministri përgjegjës; d) organizimi territorial, nëse është i

zbatueshëm, si dhe detyrat administrative të degëve territoriale dhe kompetencat e tyre territoriale.”

Në rastin konkret, kur krijohet një institucion i ri duhet të ishin përcaktuar në këtë ligj emri, selia, misioni si dhe funksioni i tij.

Ky parashikim, tërësisht i paqartë dhe në mungesë tërësore koherence me rendin e brendshëm juridik, por dhe me vetë nenin 9 të ligjit, tregon për një mungesë të theksuar të qartësisë në procesin ligjvënës, nxitimit në miratimin e përmbajtjes së dispozitave dhe në vlerësimin e nevojës së krijimit të institucioneve të reja që mbivendosin funksionet dhe detyrat që kryhen nga organe të specializuara (si Policia e Shtetit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror).

3 Neni 12 i ligjit, që përcakton dispozitën e humbjes së shtetësisë dhe neni 15 i tij bien ndesh me nenin 19 dhe 92 të Kushtetutës, Konventën Evropiane për Shtetësinë, dhe përbëjnë kufizime joproportionale të të drejtave të njeriut, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

31 Duke filluar që nga titulli dhe përmbajtja e pikës 1 të këtij neni, përdorimi i termit “humbet” shtetësinë, është në kundërshtim me terminologjinë që njihet Kushtetuta kur flet për “heqjen dorë”, ose “lënien” e saj.

32 Ndërsa sa i përket shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, dhe neni 15, këto parashikime shkelin hapur përcaktimet e neni 19 të Kushtetutës, paragrafi 2, që sanksionon në mënyrë taksative se:

“Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.”

Edhe pse në parim, për rastet e fitimit apo marrjes së shtetësisë përmes dokumenteve të falsifikuara, apo kur shtetasi me veprimtarinë e tij cenon sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë, heqja e shtetësisë mund të ishte një parashikim i nevojshëm për raste ekstreme, një parashikim i tillë duhet të ishte përcaktuar në nivel kushtetues, dhe jo në nivel ligji.

Heqja e shtetësisë, sidomos në formën e parashikuar në ligj kur në shkronjën “b” të neni 15, për shkak të pakujdesisë së hartuesve të ligjit, kuptohet sikur shtetësia shqiptare i hiqet çdo shtetasi shqiptar, pra edhe atij të lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë, për shkak se kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, veprimtaria e së cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë, është një parashikim haptazi në kundërshtim me të drejtën dhe lirinë themelore që i njihet njeriut neni 19 i Kushtetutës.

Gjithashtu me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Evropiane “Për shtetësinë”, duke e bërë pjesë të legjislacionit të vendit tonë. Neni 4 i kësaj Konvente rendit parimet mbi të cilat duhet të bazohet secili Shtet Palë: “[...] a) Secili ka të drejtën për një shtetësi; b) Pashtetësia do të shmanget; c) Asnjërit nuk do t’i mohohet arbitrarisht shtetësia e tij apo e saj; [...]”.

Neni 5, i kësaj Konvente sanksionon parimin e mosdiskriminimit, dhe citojmë:

“1. Rregullat e një Shteti Palë mbi shtetësinë nuk do të përmbajnë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktike, e cila rezulton në diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike.

2. Çdo Shtet Palë do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit ndërmjet shtetasve të tij, pavarësisht nëse ata janë shtetas nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë me pas.”

Sa më sipër, parashikimet e neneve 12 dhe 15 të ligjit, cenojnë direkt Konventën Evropiane “Për shtetësinë” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, duke bërë diferencim dhe trajtuar në mënyrë diskriminuese, pas dhënies së shtetësisë shqiptare, shtetasit që nuk e kanë pasur më parë atë, në raport me shtetasit e vetë shtetit. Akoma më problematik është ky parashikim, në rastet kur personit të cilit i hiqet shtetësia, mbetet për rrjedhojë pa shtetësi.

Ky ligj, i miratuar me këtë përmbajtje, veçanërisht në mungesë të një Gjykate Kushtetuese funksionale, rrezikon të cenojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të penalizojë Shqipërinë edhe në gjykatat ndërkombëtare, në rastet e aplikimit të parashikimit për “heqjen e shtetësisë shqiptare.”

4 Neni 18, pika 3 dhe 5, dhe neni 19, kufizojnë kompetencën e Presidentit të Republikës për dhënien dhe lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare sanksionuar në nenin 92 të Kushtetutës, si dhe pengon aplikuesit që kërkesa e tyre të shqyrtohet dhe të shprehet për themelin e kësaj kërkesë Presidenti, si organi i vetëm kushtetues, i cili ka kompetencën për dhënien/lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.

Pika 5, e nenit 18, parashikon se:

“Në rast se pas verifikimeve të kryera rezulton se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj, ministria nëpërmjet strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni njofton personin e interesuar për refuzimin e kërkesës. Refuzimi bëhet me akt administrativ të ministrit. Kundër këtij akti, personi që ka paraqitur kërkesën mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.”

Pika 1 e nenit 18, bën fjalë për verifikime që lidhen me vlerësimin e cenimit të sigurisë publike, elemente këto, që në fund merren në shqyrtim dhe vlerësohen sipas kompetencës së tij kushtetuese, nga Presidenti i Republikës.

Autoriteti i vetëm që njeh Kushtetuta për të bërë refuzimin e kërkesës për fitimin/lejimin e lënies së shtetësisë është Presidenti i Republikës, pasi të jetë njohur me aplikimin e plotë dhe verifikimet e kryera nga institucionet përgjegjëse si dhe pasi të ketë vlerësuar kërkesën.

Po në rastin kur sipas parashikimit të kësaj pike, gjykata i jep të drejtë aplikuesit/kërkuesit dhe vendos rrëzimin e “aktit administrativ të ministrit”, cili do ta zbatojë vendimin e gjykatës dhe si do të zbatohet ky vendim? Në këtë rast, ministria do të zbatojë vendimin duke përcjellë propozimin pranë Presidentit dhe këtij të fundit, do t’i duhet të nxjerrë thjesht një akt formal pa asnjë verifikim? Një parashikim i tillë kufizon kompetencat kushtetuese ekskluzive të Presidentit të Republikës për t’u shprehur për miratimin apo refuzimin e kërkesës për dhënien e shtetësisë shqiptare.

Të njëjtin kufizim bën dhe parashikimi i pikës 3 të nenit 18, që parashikon se:

*“Me paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ministria brenda 6 (gjashtë) muajve shqyrton dokumentacionin e paraqitur, me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe i përcjell Presidentit të Republikës **propozimin për nxjerrjen e dekretit**. Procedura për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse përcaktohet me udhëzim të ministrit.”*

Sjellim në vëmendjen tuaj se ministria përgjegjëse mund të përcjellë propozimin “për dhënien ose jo të shtetësisë shqiptare”, apo përkatësisht “për lejimin e heqjes dorë nga shtetësia shqiptare”, por kurrësi nuk mund t’i diktojë Presidentit të Republikës të “nxjerrë dekretin.”

Institucioni kushtetues që ka tagrin të japë, ose lejojë lënien e shtetësisë shqiptare i ka të gjithë kompetencat për të vlerësuar paraprakisht plotësinë e praktikës dhe shqyrtimit të propozimit, dhe jo thjesht të shndërrohet në një certifikues formal të propozimit të përcjellë.

Të njëjtin kufizim, madje edhe duke përdorur termonologjinë e gabuar, bën dhe pika 2, e nenit 19, të ligjit, që parashikon se: “Në përfundim të kryerjes së verifikimeve, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, ministria i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për nxjerrjen e dekretit për heqjen e shtetësisë.”

Edhe në këtë rast, ministria mund t’i përcjellë Presidentit të Republikës vetëm praktikën dhe propozimin e saj për pranimin ose jo të kërkesës për lënie shtetësie, dhe

është Presidenti i Republikës, i cili vlerëson plotësinë e praktikës dhe themelin e kërkesës, dhe në fund, mund të shprehet me dekret sipas Kushtetutës për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare, dhe jo me dekret për “*heqjen e shtetësisë.*”

5. Në nenin 20, pika 4, parashikohet se:

“Dekreti për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohet në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore, për administrimin e të cilit respektohen dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, formati i të cilit përcaktohet me udhëzim të ministrit.”

Kjo dispozitë bën të paqartë se ku do të krijohet dhe mbahet ky regjistër i veçantë për qëllime statistikore, nëse do të mbahet pranë ministrisë së Brendshme, apo pranë Institucionit të Presidentit të Republikës.

Nisur nga mungesa e qartësisë së kësaj norme, që duke mos specifikuar institucionin përgjegjës, lë të kuptohet sikur regjistri mund të mbahet edhe pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, sjellim në vëmendjen tuaj se nuk mundet ky Institucion, të ngarkohet për zbatimin e një udhëzimi të një ministri, që i dikton formatin e mbajtjes së një regjistri.

6. Duke vlerësuar në këtë ligj përfshirjen e procedurës së betimit, si një element ceremonial që lidhet pandashmërisht me të drejtën e gëzimit të shtetësisë shqiptare, një propozim dhe qëndrim i tillë nga ligjvënësi ka sjellë jo pak habi për Presidentin e Republikës, për sjelljen me dy standarde të Kuvendit të Shqipërisë, kur së fundmi, me disa ndryshime ligjore në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në rastet e funksionarëve të lartë të drejtësisë, i njëjti Kuvend e pa të panevojshme si dhe shfuqizoi ceremoninë e betimit para fillimit të detyrës.

Megjithatë, Presidenti i Republikës e mbështet këtë parashikim, siç ka mbështetur gjithashtu në disa arsyetime domosdoshmërinë e ceremonisë së betimit si një akt solemn i domosdoshëm për fillimin e një marrëdhënieje të re juridike.

Por kjo dispozitë nuk është formuluar qartë dhe përmban gabime të rënda konceptuale. Konkretisht, pika 1, e nenit 22, parashikon se:

“Dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nuk do të ketë efekt nëse brenda 6 (gjashtë) muajve nga njoftimi i tij personi nuk është betuar sipas nenit 21 të këtij ligji.”

Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi nuk njeh “humbjen e efekteve” të një dekreti të Presidentit të Republikës.

Dekreti i Presidentit në këtë rast, si një akt administrativ individual duhet të anulohet, në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Për këtë qëllim, ligji duhet të parashikojë qartë se në kryerjen e ceremonisë së betimit, ose merr pjesë një përfaqësuese i Institucionit të Presidentit të Republikës, ose një kopje e njehsuar e aktit të betimit, i përcillet për njohje Presidentit të Republikës.

Në rastet kur me kalimin e afatit ligjor, Presidenti i Republikës nuk ka administruar kopjen e aktit të betimit, pas kryerjes së verifikimeve me insitucionet përgjegjëse, duhet të ndërmarrë nismën për anulimin e dekretit për dhënien e shtetësisë shqiptare, por **dekreti nuk mund të humbasë efektet e tij, pa u shprehur organi që e ka nxjerrë atë.**

- *Argumentet ligjore kundër dekretit të Presidentit të Republikës*

Gjatë shqyrtimit të Dekretit të Presidentit të Republikës Zëvendësministri i Brendshëm Zoti Hodaj, i pranishëm në mbledhje, ftoi anëtarët e komisionit të votojnë kundër dekretit duke sjell kundërargumentat si më poshtë:

Në lidhje me pikën 1 të dekretit, ai sqaroi se ligji bën një uniformim të termave të përdorur, pra “shtetësia fitohet”, “rifitohet”, “hiqet dorë” prej saj ose “hiqet”, ndërsa organi kompetent, i cili jep ose e heq shtetësinë është në disa raste Presidenti i Republikës. Nuk ka mospërputhje ndërmjet termave të ligjit dhe termave të Kushtetutës, sepse edhe në nenin 19 flitet për fitim të shtetësisë shqiptare në rastet të lindjes apo fitim për shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji.

Kështu që në këtë aspekt Kushtetuta e lë hapur, sepse nuk mund të pretendojmë që një dispozitë kushtetuese, që duhet të jetë sa abstrakte dhe sa më koncize të jetë e mundur, të përdorë të gjitha termat e mundur që mund të përdoren në një ligj që e detajon.

Lidhur me pikën 1.2 të dekretit, periudha prej 7 vjetësh me leje qëndrimi është një kriter që na garanton siguri, sepse ka për bazë përvojën e deritanishme në dhënien e shtetësisë. Ideja është që ky ligj nuk ka ardhur nga hiçi në parlament, por ka kaluar në një proces konsultimi me të gjitha grupet e interesit dhe, sigurisht, është mësuar edhe nga përvoja e mëparshme dhe është gjykuar që termi “prej 7 vjetësh” është një kohë e mjaftueshme që të tregohet se dikush ka një lidhje të qëndrueshëm me territorin.

Pra, nuk është thjesht një mekanizëm për të përfituar një shtetësi tjetër, por ka një lidhje të qëndrueshme me territorin, sepse flasim gjithmonë për çështje që lidhen edhe me sigurinë publike.

Në lidhje me 1.3, që pretendohet te dekreti i Presidentit të Republikës, termi “ka banesë” nuk do të thotë që dikush duhet të ketë një pronësi, por është i njëjti term që përdoret edhe për lejet e qëndrimit, që do të thotë se aplikanti duhet të ketë disponibilitetin e një banese sipas standardeve të kërkuara, të cilat janë të njohur në të gjithë botën, jo vetëm te ne, dhe kanë lidhje me frymët, metrat katrorë e të tjerë.

Pra, nuk kërkohet domosdoshmërisht që të ketë pronësi, por të ketë disponibilitetin e banimit dhe të mos jetë një person pa banesë.

Në lidhje me pikën 1.4 të dekretit, kërkesa për të njohur gjuhën shqipe, kulturën dhe historinë është një kërkesë që përdoret nga shumë vende europiane kur vjen puna për dhënien e shtetësisë, sepse duhet të tregojë që ka lidhje me territorin, kulturën dhe gjuhën. Pra, ai që aplikon duhet të ketë një lidhje, që shkon përtej materiales, me vendin të cilit i kërkon edhe shtetësinë dhe detajet, siç janë: standardet, njohja apo masa e njohjes së gjuhës shqipe, nuk mund të parashikohen në ligj, duhet të detajohen në aktin nënligjor, sepse ligji, duke pasur parasysh që duhet të jetë abstrakt dhe i përgjithshëm, nuk mund të zbresë në detaje se sa duhet të jetë masa e njohjes së secilit prej këtyre elementeve.

Në lidhje me pikën 1.5 të dekretit, kjo pikë është shtuar gjatë punës në komisionet parlamentare, propozimi bërë UNHCR, por që prapë kemi lidhje me qëndrueshmërinë që duhet të ketë marrëdhënia e personit që aplikon për të qëndruar në territor.

Në lidhje me pikën 1.6, ai theksoi se ligji është i qartë, sepse pika 1.6 e dekretit të Presidentit lidhet me pikat 4, 5 dhe 6 të nenit. Është e qartë që këtu nuk bëhet fjalë për një aplikim, i cili shoqërohet më pas me një dekret të Presidentit të Republikës, por është fitimi i shtetësisë në mënyrë të vetvetishme për shkak të atyre kushteve specifike që parashikohen te ky nen, prandaj ka një shmangie nga procedurat standarde të fitimit të shtetësisë.

Në lidhje me pikën 2 të dekretit të Presidentit të Republikës, ai z.Hodaj argumentoi se është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për sa kohë që në nenin 19.1 parashikohet që shtetësia fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji. Pra, nuk shohim që ka ndonjë shmangie, sepse flasim për programe të veçanta dhe për interesa specifike të veçanta të shtetit shqiptar.

Lidhur me shqetësimet e ngritura për periudhën e përgjigjes, programet e veçanta janë ato që kanë gjithmonë lidhje me arsimin, shkencën dhe ekonominë, ku personazhe të shquara, që kanë një kontribut për vendin, do të duhet patjetër që në një farë mënyre të kompensohen dhe të shpërblehen për punën e tyre.

Lidhur me rregullat specifike, është e qartë në ligj që të gjitha rregullat specifike aplikohen kundrejt të gjitha subjekteve kërkuese dhe propozimi është natyrshëm, siç është edhe në praktikën e deritanishme, që propozimi kryhet nga institucionet përgjegjëse për fushën specifike të veprimit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme.

Në lidhje me pikën 2.6 të dekretit të Presidentit të Republikës, roli dhe funksioni i agjencisë patjetër që duhet të detajohen me akte nënligjore, por nuk po flasim për një agjenci autonome, siç pretendohet. Flasim për një agjenci që është në varësi të ministrit, ku, pavarësisht emërimit, është një institucion varësie dhe institucionet e varësisë krijohen gjithmonë me një vendim të Këshillit të Ministrave, pa pasur nevojë të specifikohet më tutje qoftë emri i saktë, selia apo misioni në ligj.

Në lidhje me pikën 3 të dekretit të Presidentit të Republikës, neni 15 e ka shumë të qartë. Kjo humbja zbatohet vetëm për shtetasit që e kanë fituar nënshtetësinë shqiptare

me natyralizim dhe vetëm nëse personi nuk rrezikon të mbetet pa shtetësi. Pra, respektohen edhe kërkesat specifike të konventës deri në fund, edhe parimet e ligjit “Për shtetësinë”.

Kur flasim për humbje të shtetësisë, konkretisht **pika 3.1 e dekretit të Presidentit të Republikës**, kemi dy raste: rasti i parë është rasti për dokumente të falsifikuara. Nëse arrijmë te konkluzioni që dhënia e shtetësisë në fund të ditës është një akt administrativ individual, falsifikimi i dokumentit në çfarëdolloj faze të kësaj procedure çon automatikisht në pavlefshmëri të të gjitha akteve që vijnë, pra në këtë rast nuk ka ndonjë paqartësi.

Kurse në pikën “b” për përfshirjen në aktivitete terroriste apo ato që cenojnë sigurinë kombëtare, është parashikuar një procedurë heqjeje, pra është më se normale, sepse ka edhe një lloj ndryshimi ndërmjet atyre që fitojnë të drejtën e shtetësisë si pasojë e lindjes nga prindër shqiptarë, pra kanë një të drejtë natyrale, dhe e atyre që e fitojnë me mirëbesim në saj të raportit që kanë ndërtuar me shtetin shqiptar. Në këtë rast është normale që dikush, që e ka fituar shtetësinë mbi bazën e raportit të besimit me shtetin shqiptar, në rast se nuk përmbush detyrimet e tij individuale, të ketë edhe konsekuencën e heqjes së shtetësisë. Ka ekzistuar edhe në legjislacionin e kaluar dhe ekziston edhe në legjislacionin që është në fuqi e njëjta procedurë dhe quhet evokim, por në këtë rast është bërë edhe unifikimi i termave, në mënyrë që të mos shkaktonim dëm në lidhje me këta lloj termash të përdorur në ligj.

Në lidhje me pikën 4 të dekretit të Presidentit të Republikës, në asnjë rast Ministria e Brendshme nuk mund ta kushtëzojë dekretin e Presidentit të Republikës. Pra, në çdo rast flitet për propozime që vijnë nga institucioni që është përgjegjës për këtë fushë dhe në fund fare është tagri i Presidentit që të japë një dekret në përputhje me atë kompetencë që i njeh Kushtetuta.

Në lidhje me pikën 5 të dekretit të Presidentit, pa dyshim që databaza do të jetë në kompetencën e Ministrisë së Brendshme do të miratohet, do të krijohet dhe do të përpunohet nga Ministria e Brendshme, sepse është më se normale që me urdhër të ministrit të Brendshëm, nuk mund të kushtëzohet aktiviteti i një institucioni kushtetues, siç është Presidenti i Republikës. Kështu që nuk besoj se ka ndonjë keqkuptim apo nevojë për sqarime të mëtejshme në këtë pikë.

Për sa i përket procedurës së betimit, kjo është një procedurë e njohur gjithandej në të gjitha vendet e botës. Pra, meqenëse themi dhe vetë institucioni i Presidencës e pranon që dekreti për dhënie e shtetësisë është një akt administrativ individual, nuk duhet të ngatërrojmë dy koncepte: prodhimin e efekteve nga një akt me vlefshmërinë e një akti. Një akt mund të jetë shumë mirë i vlefshëm, por nuk prodhon efete. Akti në vetvete ngelet i vlefshëm, por nuk do të prodhojë kurrë efekt për shkak të neglizhencës së palës tjetër që ka detyrimin të performojë edhe ai një akt individual që është ajo e besnikërisë ndaj shtetit shqiptar.

Në përfundim të fjalës së Z.Hodaj, kryetarja e komisionit, zonja Felaj, para se t’i jepte fjalën relatores zonjës Elona Gjebrea, sqaroi se ky është një ligj që miratohet me shumicë

të cilësuar cili duhet lexuar me shumë kujdes. Diskutimi në Kuvendin e Shqipërisë ka marrë një kohë të konsiderueshme, por aq edhe debati dhe konsultimi me grupet e interesit.

Mandej ajo sqaroi se ky ligj nuk ka qenë për diskutim thjesht dhe vetëm në Komisionin Sigurisë Kombëtare por Komision për dhënie mendimi për këtë ligj ka qenë Komisioni për Çështjet Ligjore, i cili gjatë fazës së shqyrtimit të këtij ligji është konsultuar me disa institucione, duke filluar nga Avokati i Popullit, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilët janë është shprehur dakord me përmbajtjen e ligjit. Në disa raste komentet e bëra nga të tria këto institucione janë marrë parasysh dhe janë pranuar duke u votuar pro nga ana e anëtarëve të Komisionit të Ligjeve dhe po të njëjtën mbështetje ka pasur edhe në Komisionin e Sigurisë.

Po kështu znj.Felaj rikujtoi se Komisioni i Sigurisë, që në seancën e parë të prezantimit të përmbajtjes së ligjit “Për të shtetësinë” ka ftuar përfaqësuesin e posaçëm të UNHCR-së në Shqipëri, i cili ka mbajtur kontakte edhe para se ligji të çelej për diskutim dhe kontaktet nuk kanë qenë thjesht dhe vetëm verbale, apo interesim për përmbajtjen e ligjit, por ato janë materializuar edhe në një korrespondencë të Komisionit të Sigurisë dhe përfaqësuesit, ambasadorit të UNHCR-së, zoti Pablo Zapata, i cili ka qenë edhe gjatë diskutimit nen për nen.

Gjithashtu, vëmendjen për përmbajtjen e këtij projektligji e ka pasur edhe Komisioni Europian, posaçërisht delegacioni i BE-së në Republikën e Shqipërisë, i cili na ka vënë në dijeni të komenteve të tij për nene të veçanta të këtij ligji, të cilat janë mbajtur parasysh të gjitha. Pra, pretendimi që ligji nuk është konsultuar thjesht dhe vetëm nga këto të dhëna nuk qëndron, sepse ligji është konsultuar dhe kjo nuk rezulton thjesht nga koha e gjatë e qëndrimit në Kuvend, por nga fakti që është diskutuar realisht nga faktorë dhe grupe interesi.

Detyrimin për të konsultuar publikisht projektligjet nuk e ka vetëm Kuvendi i Shqipërisë, e kanë edhe institucionet, që janë propozuesit e projektligjit, në këtë rast. Është një proces, i cili zhvillohet në mënyrë të pavarur nga Kuvendi i Shqipërisë. Ashtu si Kuvendi i Shqipërisë vendos për aktorët dhe grupet e interesit me të cilët diskuton përmbajtjen e një ligji, të njëjtën pavarësi në përzgjedhjen, ose në thirrjen e grupeve të interesit e kanë edhe institucionet, për më tepër që ne kemi një ligj tani të konsultimit publik, që detyron respektimin e një përgjegjësie të tillë.

Në fjalën e saj relatorja znj. Gjebrea parashtrroi si më poshtë:

Në radhë të parë, ajo vuri në dukje faktin se ky projektligj “Për shtetësinë” është në harmoni të plotë me Konventën Europiane për Shtetësinë, që është ratifikuar me ligjin nr. 8942, datë 19.09.2002 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për shtetësinë”, si dhe për Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9059, datë 08.05.2003. Po ashtu është shumë e rëndësishme për t’u përsëritur fakti i konsultimit që ky projektligj ka pasur me të gjitha grupet e interesit dhe, në hartimin e

këtij projektligji, grupi ndërinstitucional i punës ka kryer hulumtime edhe të sistemeve të shteteve anëtare të BE-së, si: Italia, Kroacia dhe Sllovenia, është marrë në konsideratë legjislacioni i tyre, që kanë sistem të përafërt me atë të vendit tonë, duke mos synuar vetëm përafrimin e modelit, por edhe arritjen e standardeve.

Në lidhje me argumentet që i përkasin neneve 19 dhe 92 të Kushtetutës, znj.Gjebrea theksoi se Kushtetuta është një dokument themeltar i shtetit, i cili parashikon bazën dhe parimet mbi të cilat do të funksionojë shteti ligjor. Në asnjë rast Kushtetuta nuk mund të detajojë, apo të përkufizojë kriteret dhe procedurat, që do të jenë pjesë e akteve ligjore dhe nënligjore. Në këtë kontekst, neni 19 i Kushtetutës ia jep atributet këtij ligji.

Ligjin “Për shtetësinë”, i cili ka 26 nene, që ne i kemi miratuar me një konsensus edhe në parlamentin e Shqipërisë, ka 11 akte nënligjore dhe 4 udhëzime. Pothuajse në shumicën e atyre neneve, pika e fundit e çdo neni ka të bëjë me përcaktimin e akteve nënligjore, apo dokumentacionet e nevojshme, që do të plotësohen dhe përcaktohen me udhëzim të ministrit. Kjo shpjegoi edhe disa nga kërkesat, apo nga pyetjet që institucioni i Presidencës ka bërë në lidhje me këtë projektligj.

Po ashtu, në lidhje me aplikimin e kriterit për periudhën prej 7 vjetësh, ajo sqaroi se ky është një ndryshim që ka për bazë shumë aspekte: përvojën e deritanishme, konsultimet me grupet e interesit, strukturat përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, por duke pasur parasysh edhe lëvizjen e madhe demografike, flukset e emigracionit, pra çdo gjë, lëvizjet emigratore, pa dyshim, duke mos harruar edhe rritjen e rrezikut për terrorizmin. Hartuesit janë treguar të kujdesshëm që të jenë të përcaktuara qartë momentet kur personat nuk mund të marrin shtetësi për arsye të kërcënimit, të përfshirjes në krim të organizuar apo rrezik të terrorizmit. Në këtë rast, pa dyshim, edhe parimi i mosdiskriminimit, që u përmend edhe nga zonja Treska, është i përcaktuar me kujdes. Sigurisht që detajimi i kërkuar nuk ka të bëjë me kriteret e vendosura në ligj, i cili është i vendosur, por me dokumentacionin dhe procedurat, që, sikurse u tha edhe nga zëvendësministri, do të jenë të përcaktuara qartë me udhëzim të ministrit.

Po ashtu, në lidhje me Agjencinë Shtetërore të Posaçme as theksoi se në këtë stad ku jemi dhe me të gjitha ndryshimet dhe amendimet, të cilat janë vërtet një përmirësim i dukshëm i ligjit të mëparshëm për sa i përket shtetësisë, ka nevojë për disa struktura mbështetëse. Pa dyshim aktet nënligjore janë ato, të cilat do ta bëjnë të qartë çfarë roli dhe funksioni ka kjo agjenci shtetërore e posaçme. Por, sigurisht, edhe Komisioni i Sigurisë do të jetë i kujdesshëm për t’i monitoruar ato. Madje, një nga detyrimet që ne kemi është të monitorojmë edhe se sa këto akte nënligjore të ligjeve të ndryshme zbatohen konform rregullave që përcaktohen në ligj. Pa dyshim, në momentin që ne shikojmë një dobësi apo një moment i cili duhet të diskutohet, ne ngremë alertin, por Komisioni i Sigurisë Kombëtare e ka kryer më së miri këtë punë.

Në lidhje me pjesën që ka të bëjë me të drejtat e Presidentit, me nenin 18, që kufizojnë, pikat 3 dhe 15, dhe nenin 19, që parashtrohet nga kufizimi i të drejtave të Presidentit nga ekspertët e Presidencës ajo sqaroi se Ministria e Brendshme është, në fakt, institucioni

përgjegjës për kryerjen e procedurave verifikuese të personit apo të dokumentacionit. Kështu ka qenë dhe kështu do të jetë, ku, në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, dalin me një rezultat konkret, në bazë të vlerësimit, i cili pastaj konvergohet për propozim për dhënie ose jo të dekretit nga ana e Presidentit. Këto janë procedura, të cilat janë konform standardeve dhe rregullave që ndjekin edhe të gjitha vendet e tjera për sa i përket dhënies së shtetësisë. Pra, baza për dhënien ose lënien e shtetësisë është verifikimi i personit dhe i dokumentacionit përkatës; nuk mund të bazohet në vlerësimet që dalin jashtë këtij konteksti.

Po ashtu, lidhur me procedurën e betimit, përsëri është një procedurë e cila kryhet nga vendet e Bashkimit Europian me të njëjtin format që është parashikuar edhe në projektligjin që ne kemi kaluar dhe kemi miratuar, ku betimi bëhet përpara kryetarit të bashkisë, njësisë administrative apo përfaqësuesve të shtetit në përfaqësitë e huaja jashtë vendit, që edhe kjo e ka lehtësuar shumë punën, sepse betimi nuk ka qenë i parashikuar për përfaqësitë e huaja jashtë vendit në ligjin e mëparshëm. Vende si Italia dhe Greqia e kanë aplikuar këtë procedurë dhe këtë format për kryerjen e betimit.

Për sa më sipër, zonja Hoxha ftoi anëtarët e komisionit të votojnë kundër Dekretit të Presidentit të Republikës nr.11591, datë 10.08.2020, “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.113/2020, “Për shtetësinë”.

- ***Përfundime***

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, votoi pro rrëzimit të Dekretit Presidentit të Republikës nr.11591, datë 10.08.2020, “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.113/2020, “Për shtetësinë” dhe kalimin e tij seancës plenare në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Relator

Kryetar

Elona (Gjebrea) HOXHA

Ermonela (Felaj) VALIKAJ